



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 26.01.2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Etem Arifi, Teuta Haxhiu, dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Jasmina Zhivković dhe Valdete Bajrami.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit UNICEF.

Të ftuar: Enver Halimi-ZRRE, Ymer Fejzullahu-ZRRE, Visar Azemi-KOSID.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj-YIHR, Agron Demi-GAP, Diana Berisha-FIQ, Dren Doli-GLPS, Selvet Gerxhaliu-GDNJD, Selma Seković-OSCE, Lejla Selimi-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.02;
3. Shqyrtimi i Peticionit nr.01/2015, kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja Lirije Kajtazi propozoi që për respekt të të ftuarve, që të mos humbin shumë kohë dhe të fillohet me pikën e tretë të rendit të ditës. Rendi i ditës u miratua me këtë propozim.

3. Shqyrtimi i Peticionit nr.01/2015, kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.(Të ftuar në mbledhje, për këtë pikë të rendit të ditës, janë:përfaqësuesi i Peticionit, dhe përfaqësuesi i ZRRE-së.)

Lirije Kajtazi, kryetare, tha se për këtë peticion kemi ftuar të dy palët; përfaqësuesit e Peticionit dhe përfaqësuesit e ZRRE-së. Ne si komision, tha ajo, do të dëgjojmë të dy palët dhe pastaj do të dalim me një përfundim se çka është kompetencë jona dhe se ku të adresohet ky peticion.

Visar Azemi, përfaqësues i peticionit, fillimisht përshëndeti anëtarët e komisionit dhe të pranishmit e tjerë, duke thënë se pas ngritjes së dytë të çmimit të energjisë që ndodhi vitin e kaluar, një koalicion i shoqatave dhe i sindikatave u bëmë bashkë dhe morëm disa vendime e nisma. Pasi që asnjëherë nuk u shpjegua që kjo ngritje e çmimit u bë vetëm për ti evituar dëmet që u bënë në termocentral dhe pastaj çmimi do të kthehet në gjendjen e mëparshme. Ne u organizuam nëpër disa komuna dhe për disa ditë mbledhëm afër 33 mijë nënshkrime dhe kjo është një indikacion se sa janë të pakënaqur qytetarët dhe sa shpejt u mobilizuan për ta nënshkruar një peticion të tillë për të kundërshtuar një vendim, i cili erdhi i paargumentuar dhe joprofesional. Kjo rritje nga ZRRE-ja, është bërë pa marrë për bazë gjendjen sociale dhe ekonomike që mbretëron në Kosovë.

Enver Halimi-ZRRE, tha se çka do që kemi vepruar është në kuadër të ligjit për rregullatorin e energjisë, në kuadër të legjislacionit primar dhe atij sekondar. Ekziston një ligj në bazë të cilit kemi punuar, ZRRE-ja nuk është në pozitë të lakmueshme. Problemi është më kompleks dhe nuk mbetet faji vetëm në ZRRE. Në Kosovë nuk ka energji të mjaftueshme, prandaj duhet të ndërtohen termocentrale dhe hidrocentrale të reja.

Ymer Fejzullahu, drejtues i Departamentit për Tarifa dhe Çmime në ZRRE, ne, me të gjitha pikat që u ngritën nga Visari jemi dakord. Ne e kemi kundërshtuar rritjen, nuk jemi kompetent me ndryshua ligje, sa i përket shpërthimit në Kosovën A, e them se konsumatorët nuk janë duke paguar për dëmet që janë shkaktuar në KEK, por janë duke paguar për energjinë, që duhet të zëvendësohet ajo energji me energji të blerë në tregun ndërkombëtar. Tvsh-ja nuk është taksë që ZRRE-ja e cakton, këtë e cakton qeveria në bashkëpunim me Kuvendin. Sa i përket tarifave, Kosova është vendi me tarifa me ulëta të energjisë elektrike në Evropë.

Agron Demi-GAP, kërkoi që ky peticion të merret në konsideratë në të gjitha pikat dhe jo vetëm në disa pika.

Mytaher Haskuka tha se me sa u pa, palët në katër pika pajtohen mes veti, meqë ka zbritje të çmimit të naftës. A ka mundësi të shqyrtohet edhe zbritja e energjisë elektrike. Dihet se qytetarët e Kosovës gjatë dimrit paguajnë më shumë se gjysmën e pagës për

ngrohje, nuk e besojë që është në vendet e tjera e njëjta situatë. Diskutohet gjithmonë kur ka rritje të çmimit, por jo edhe kur ka zbritje të çmimit.

Etem Arifi tha se është një peticion i drejtë, sepse ZRRE-ja thotë se i kemi trashëguar rregulloret, por nëse kanë qene në kundërshtim me ligjin, është dashtë me i ndryshua, për shkak të situatës politike. Është e vërtetë se bordi ka vazhduar të punojë me tre anëtarë. U tha se çmimi është më i ulët në Evropë, a janë marrë parasysh të hyrat e qytetarit për tu bazuar në çmimet e tregut në Evropë. Nuk është e njëjtë një euro si këtu si fjala vjen në Zvicër. Ne si Komision duhet ta shqyrtojmë mirë këtë peticion dhe duhet ti adresohemi Kuvendit lidhur me këtë.

Teuta Haxhiu pyeti se për kë dhe në interes të kujt punon ZRRE-ja. Është skandaloze çka po ndodh me qytetarët e Kosovës në përgjithësi. Të paguhen 50-70 euro rrymë, nga një familje që ka mbështetje sociale prej një pensioni të moshës prej 75 euro, kjo është e pashpjegueshme. E them me argumente, gjatë gjithë kohës punojnë me dru dhe paguan prej 70-80 euro rrymë gjatë dy muajve të fundit, për mu kjo është e paqartë dhe nuk di ta shpjegojë, sepse dëmet që janë bërë dhe ajo çka ka ndodhur, nuk është faji i qytetarëve. Këtë peticion do ta adresojmë në Parlament. Pajtohem me të gjitha pikat që janë në këtë peticion, theksoi Haxhiu.

Kujtim Paqaku tha se për shkak të pamundësisë së pagesës së rrymës, komuniteti rom ashkali dhe egjiptian ka braktisur Kosovën. Po ashtu janë edhe faktorë të tjerë, si varfëria papunësia e me radhë. Si deputet do ta mbështesë këtë peticion që është edhe në favor të komuniteteve. Unë do të kërkoj në foltore të Kuvendit që shtresat sociale mos ta paguajnë rrymën apo kostoja të jetë minimale, tha Paqaku.

Mexhide Mjaku-Topalli, është shqetësuese kjo situatë sepse kostoja është shumë e lartë, me intereson të dije a ka shkelje të ligjit për këtë shtrenjtim të rrymës.

Salihe Mustafa-e kemi obligim me diskutua për këtë çështje edhe në kuvend dhe të shohim çka do të bëjmë përmes kuvendit dhe të zgjidhet çështja ashtu si duhet sepse jemi përfaqësues të dy palëve dhe e kemi obligim ti mbrojmë qytetarët.

Ymer Fejzullahu tha se të gjitha çështjet që u ngritën, si ZRRE jemi në anën e popullit. Sa i përket rënies së çmimit të naftës, jemi në proces të shqyrtimit. Duhet të ketë subvencione nga qeveria. Konsumatorët e pakënaqur e kanë në dispozicion një këshillë juridike, të drejtën e ankesës. Disa na kanë paditur edhe në gjykata, dhe gjykata vendos a kemi vepruar në pajtim me ligjin apo jo.

Visar Azemi theksoi se është mirë të formohet një komision hetimor dhe të shikojmë si ka ndodhur rritja e dy çmimeve të njëpasnjëshme dhe të dalin me përgjigje konkrete. Është mirë që edhe anëtarët e komisionit kanë vullnet që shumë shpejt këtë problem të qytetarëve të Kosovës ta adresojnë për shqyrtim në Kuvend.

Teuta Haxhiu tha se në komision e shqyrtojmë këtë peticion dhe duhet të nxjerrim një përfundim dhe ta procedojmë atë në kryesi të Kuvendit.

Lirije Kajtazi, kryetare, tha se dëgjuam të dy palët dhe morëm informacionet e nevojshme. Konstatoj se komisioni njëzëri vendosi të nxjerr këtë:

Përfundim

Peticioni i nënshkruar nga qytetarët kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike i plotëson kushtet formale për procedim të metutjeshëm.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 02;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 20.01.2015, u miratua pa vërejtje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi